



HEKURUDHAT E KOSOVËS TRAINKOS SH.A.

RAPORT

Prill – Qershor 2025



FUSHË KOSOVË,
Gusht 2025

PËRMBAJTJA

I.	HYRJJE	3
II.	STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK-TRAINKOS SH. A.	4
III.	TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR	5
III.1	Gjendja financiare prill – qershor 2025	5
III.1.1	Të hyrat	6
III.1.2	Shpenzimet	6
III.2	Gjendja në para të gatshme – raporti sipas bankës më 30.06.2025	11
III.3	Transaksionet e realizuara (prill – qershor 2025)	11
III.4	Bilanci i gjendjes (30.06.2025).....	12
IV.	TRANSPORTI I UDHËTARËVE	13
IV.1	Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TU	13
IV.2	Numri i trenave, tren kilometër (t/km) dhe udhëtarë kilometër (u/km)	14
IV.3	Vonesat e trenave të udhëtarëve	15
V.	TRANSPORTI I MALLRAVE	16
V.1	Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TM	16
V.2	Shfrytëzimi i trenave	19
V.3	Efektiviteti i trenave	19
V.4	Neto-ton & neto-ton-kilometër të transportuar	19
V.5	Revokimi i trenave	20
VI.	MIRËMBAJTJA E MJETEVE LËVIZËSE – MML	21
VI.1	Pasqyra e performancës operative	21
VI.2	Spektori i Mirëmbajtjes.....	21
VI.3	Mirëmbajtja e trenave motorikë.....	21
VI.4	Mirëmbajtja e lokomotivave transportuese.....	21
VI.5	Mirëmbajtja e lokomotivave manovruese.....	22
VI.6	Intervenimet në mjetet tërheqëse.....	22
VI.7	Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve.....	23
VI.8	Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave.....	23
VI.9	Riparimi i vagonëve të huaj.....	23
VII.	PROJEKTET DHE PROKURIMI.....	24
VII.1	Projektet kapitale	24
VIII.	KONTESTET LIGJORE.....	27
VIII.1	Kontestet ligjore për vitin 2025	28
IX.	AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT	28
IX.1	Planifikimi dhe zhvillimi i biznesit.....	28
IX.2	Aktivitetet në transportin e mallrave.....	29
IX.3	Aktivitetet në fushën promovuese.....	29
IX.4	Bashkëpunimi me hekurudhat e vendeve tjera.....	30
IX.5	Pjesëmarrja e HK-Trainkos Sh.A. në iniciativat e BE-së.....	31
IX.6	Koordinimi i proceseve me ARH-në, MMPHI-në dhe institucioneve tjera relevante.....	32
X.	Sfidat kryesore gjatë periudhës prill – qershor 2025 dhe veprimet për të ardhmen.....	33

I. HYRJE

Raporti për periudhën prill - qershor 2025, për HK-Trainkos Sh.A., është karakterizuar kryesisht më përpjekjen e të gjitha niveleve organizative të Ndërmarrjes duke filluar nga Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti e deri te stafi ekzekutiv për arritjen e rezultateve më pozitive në kushtet dhe mundësitë ekzistuese.

Ky raport paraqet aktivitetet gjatë këtij tre mujori (prill - qershor 2025) në funksion të arritjes së objektivave të vendosura me Planin e Biznesit. Po ashtu, në këtë raport pasqyrohen vështirësitë dhe sfidat gjatë zhvillimit të aktivitetit të Ndërmarrjes për këtë tremujor, sfida këto që përcillen nga periudhat paraprake e që ndikojnë drejtpërdrejt në (mos) arritjen e planifikimeve.

Sfidat për këtë periudhë kanë qenë nga më të ndryshmet, duke u përballur me të gjitha vështirësitë që vijnë nga mungesa e kërkesës në treg, veçanërisht atyre të transportit të mallrave nga shkaku i mbylljes së Linjës së 10-të Hekurudhore. Mbyllja e kësaj linje ka pamundësuar zhvillimin e transportit ndërkombëtar dhe transportin e brendshëm të mallrave. Newco Ferronikeli, si klienti ynë kryesor, edhe pse ishte zotuar për transport të brendshëm të mallrave, kjo nuk është realizuar.

Transporti i udhëtarëve në Linjën Prishtinë – Pejë dhe anasjelltas vazhdon të bëhet me shumë vështirësi, kjo për shkak të vjetërsisë dhe gjendjes jo të mirë të mjeteve tërheqëse dhe të tërhequra.

Sa i përket transportit të udhëtarëve në Linjën Prishtinë – Shkup - Prishtinë (Maqedoni e Veriut) treni ende nuk është lëshuar në qarkullim për shkak punimeve që janë duke u zhvilluar në rehabilitimin e Linjës së 10-të Hekurudhore, Fushë Kosovë – Hani i Elezit. Kjo ndërprerje e qarkullimit do të vazhdojë deri në rehabilitimin e plotë të këtij segmenti hekurudhor.

Pavarësisht vështirësive të paraqitura, HK-Trainkos Sh.A. ka vazhduar përpjekjet për të menaxhuar situatën dhe për të siguruar funksionimin e proceseve të brendshme në përputhje me mundësitë e kufizuara. Megjithatë, ndikimi i faktorëve të jashtëm, përfshirë ndërprerjet e linjave hekurudhore dhe mungesa e kërkesës për transport mallrash, ka bërë të pamundur realizimin e objektivave të Planit të Biznesit për këtë periudhë.

II. STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK – TRAINKOS SH.A.

Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, moshën e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK - Trainkos - SH.A është si vijon:

Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të HK - Trainkos - SH.A., më 01 Prill 2025 dhe më 30 Qershor 2025				
Totali i të punësuarve	01.04.2025		30.06.2025	
	156		160	
Vlerat	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje	
Datat	01.04.2025	30.06.2025	01.01.2025	30.06.2025
Mosha mesatare e punëtorëve	48.38 %	48.27 %	%	%
Në marrëdhënie të rregullt pune	156	160	%	%
Meshkuj	132	136	84.61 %	85 %
Femra	24	24	15.38 %	15 %
Serbë	1	1	0.64 %	0.62 %
Shqiptarë	155	159	99.35 %	99.37 %
Me shkollim fillor	2	2	1.28 %	1.25 %
Me PM (përgatitje të mesme) shkollore	80	84	51.28 %	52.5 %
Me kualifikim profesional	20	20	12.82 %	12.5 %
Me përgatitje të lartë	2	2	1.28 %	1.25 %
Me përgatitje superiore	52	52	33.33 %	32.5 %
Zyrtarët e Lartë	3	3	1.92 %	1.87 %
Departamenti për Operime Hekurudhore	91	95	58.33 %	59.37 %
Departamenti i Administratës	33	33	21.15 %	20.62 %
Departamenti i Financave	4	4	2.56 %	2.5 %
Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim të Biznesit	11	11	7.05 %	6.87 %
Kabineti i KE-së	2	2	1.28 %	1.25 %
Zyra e Prokurimit	2	2	1.28 %	1.25 %
Njësia e Auditimit të Brendshëm	1	1	0.64 %	0.62 %
Sektori i Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	9	9	5.76 %	5.62 %

Vërejtje: Në tabelën e cekur më lartë nuk janë përfshirë anëtarët e Bordit të Drejtorëve.

Gjatë tremujorit Prill - Qershor 2025, në Ndërmarrje nuk ka pasur lëvizje/ndryshime të stafit në numrin e përgjithshëm të të punësuarve.

Lëvizjet e të punësuarve – TM2-2025

Nr.	Emërtimi	Prill	Maj	Qershor	
1	Aktiv në fillimmuaj	159	156	156	160
2	Të pensionuar	0	0	0	0
3	Të larguar	0	0	0	0
4	Të vdekur	0	0	0	0
5	Të dorëhequr	3	0	0	3
6	Të punësuar	0	0	4	4
7	Frekuenca në fundmuaj	159	156	160	160

Në bazë të të dhënave në tabelën me lart, shihet se numri i përgjithshëm i punëtorëve më datën 01.04.2025 kanë qenë 156, ndërsa me datën 30.06.2025 kanë qenë 160 punëtorë.

Shpjegim i tabelës lëvizjet e të punësuarve – TM2 - 2025

Gjatë këtij tremujori kanë filluar punën 5 punëtorë të rinj sipas konkurseve, mirepo po atë ditë edhe pse e ka nënshkruar kontratën punëtori Sahit Hoxha ka shkëputur marrëdhënien e punës, kështu që punëtorë të rinj janë llogaritur 4.

III. TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR

1. Gjendja financiare Prill – Qershor 2025
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (30.06.2025)
3. Transaksionet e realizuara (Prill - Qershor 2025)
4. Bilanci i Gjendjes (30.06.2025)

III. 1 Gjendja financiare Prill – Qershor 2025

Për periudhën raportuese Prill - Qershor 2025, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

III. 1.1. Të hyrat

Gjatë periudhës Prill - Qershor 2025 nga **transporti i mallrave** nuk kemi realizuar të hyra. Totali i të hyrave të planifikuara nga transporti i mallrave për këtë periudhë raportuese ka qenë 250,000.00€, e cila nuk është realizuar për arsye që linja e 10-të ende qëndron e mbyllur, gjithashtu edhe klienti ynë kryesor Newco Ferronikel nuk është duke realizuar të hyra nga transporti i brendshëm.

Transporti i udhëtarëve për periudhën Prill - Qershor 2025 është realizuar në shumën totale prej 350,955.36€. Prej këtyre të hyrave, nga transporti i kontraktuar me MMPHI për OSHP janë realizuar 205,030.02€, nga të hyrat e planifikuara nga subvencioni për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve nga ME janë realizuar 125,005.71€, ndërsa të hyrat nga biletat janë realizuar në shumën prej 20,919.63€.

Totali i të hyrave të planifikuara nga transporti i udhëtarëve për këtë periudhë raportuese ka qenë 495,068.75€, realizimi i të cilave është arritur në shkallën prej 70.89%.

Të hyrat nga shërbimet tjera gjatë periudhës Prill - Qershor 2025 janë realizuar në shumën prej 1,525.42€. Kjo e hyrë është realizuar nga kontrata me kompaninë GCF në vlerë prej 1,500.00€ dhe shitja e bureve të zbraza në vlerë prej 25.42€, ndërsa në pozicionin e të hyrave nga RIV-i dhe vendosje e vagonëve në binarë nuk kemi realizuar të hyra për këtë periudhë.

Të hyrat totale nga kjo kategori kanë qenë të planifikuara në shumën prej 7,500.00€, ndërsa realizimi i tyre është arritur në shkallën prej 20.34%.

Të hyra tjera të cilat janë realizuar gjatë periudhës Prill - Qershor 2025, kanë arritur shumën prej 11,472.65€. Këto të hyra janë realizuar në pozicionet si: të hyrat nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh.A., në shumën prej 3,951.39€, të hyrat nga qiraja në shumën prej 5,084.75€, të hyrat nga shitja e skrapit në vlerë prej 2,109.90€ si dhe të ardhura nga interesi nga llogaria FLEX në vlerë prej 326.91€, ndërsa nga pozicioni i të hyrave nga shitjet tjera (riparimi i vagonëve) nuk kemi realizuar të hyra në këtë periudhë. Të hyrat nga kjo kategori, krahasuar me planifikimin prej 26,500.00€, janë realizuar në shkallën prej 43.29%.

III. 1.2. Shpenzimet

Shpenzimet për periudhën Prill - Qershor 2025, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

Totali i kostos së shërbimit për periudhën raportuese është në shumën prej 50,883.66€. Planifikimi i këtyre shpenzimeve për TM2 ka qenë në shumën prej 305,375.00€ dhe arrin kuotën e realizimit në shkallën prej 16.66%.

Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën prill – qershor 2025.

Shpenzimet e stafit janë kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur realizimin në shumën prej 298,292.12€. Këto shpenzime kanë qenë për kategorinë paga dhe kontribute në vlerë prej 298,092.12€ dhe 200.00€ kanë qenë për trajnime apo shpenzime tjera. Në total, nëse e krahasojmë shumën e buxhetuar (362,500.00€) për TM2 të vitit 2025, në këtë kategori kemi arritur kuotën e realizimit në shkallën prej 82.29%.

Totali i shpenzimeve operative arrin shumën prej 2,758.21€, e cila është realizuar në shkallën prej vetëm 10.58% nga shuma e planifikuar prej 26,075.00€ për TM2 - 2025. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën prill – qershor 2025.

Totali i shpenzimeve administrative ka arritur në kuotën prej 24.53%, konkretisht në shumën prej 7,124.80€. Planifikimi për këto shpenzime për TM2-2025 ka qenë në shumën prej 29,050.00€. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën prill – qershor 2025:


Të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Prill – Qershor 2025

	EMËRTIMI	Planifikimi Prill - Qershor 2025	Realizimi Prill - Qershor 2025	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Prill - Qershor 2024
	A	B	C	D	E	F
A	Shitjet					
1	Transporti i mallrave	250,000.00	-	250,000.00	-	4,700.00
2	TU – Ministria e Infrastrukturës	325,000.00	205,030.02	119,969.98	63.09	234,273.72
3	TU – Ministria e Ekonomisë	152,568.75	125,005.71	27,563.04	81.93	152,568.75
4	TU – Shitja e Biletave	17,500.00	20,919.63	(3,419.63)	119.54	17,760.35
5	Shërbimet tjera	7,500.00	1,525.42	5,974.58	20.34	1,500.00
6	Të ardhurat nga riparimi i vagonëve të huaj	5,000.00	-	5,000.00	-	-
7	Të hyrat tjera jo operative	21,500.00	11,472.65	10,027.35	53.36	11,702.50
I	TOTAL – TË HYRAT	779,068.75	363,953.43	415,115.32	46.72	422,505.32
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikantet	193,500.00	-	193,500.00	-	73,822.03
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	5,375.00	3,269.19	2,105.81	60.82	4,806.38
3	Inventar dhe pajisje	1,250.00	-	1,250.00	-	567.80
4	Material harxhues	250.00	-	250.00	-	-
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	15,000.00	52.19	14,947.81	0.35	1,115.26
6	Qasja në binarë	80,000.00	41,817.14	38,182.86	52.27	43,543.08
7	Sigurimi i palëve të treta	1,250.00	1,680.00	(430.00)	134.40	1,692.00
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	2,500.00	-	2,500.00	-	-
9	KMSH Nafta Infrakos	5,000.00	4,065.14	934.86	81.30	4,030.52
10	Servisimi i arkave fiskale	1,250.00	-	1,250.00	-	-
12	Zbritjet e lejuara	-	-	-	-	-
	TOTAL – KOSTOJA E SHËRBIMIT	305,375.00	50,883.66	254,491.34	16.66	129,577.07
	Fitimi (humbja) bruto	473,693.75	338,064.06	135,629.69	71.37	292,928.25
C	Shpenzimet e stafit					
1	Pagat dhe kontributet	361,250.00	298,092.12	63,157.88	82.52	353,526.34
2	Sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera	1,250.00	200.00	1,050.00	16.00	-
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	362,500.00	298,292.12	64,207.88	82.29	353,526.34
D	Shpenzimet operative					

1	Mirëmbajtje dhe riparime	1,250.00	-	1,250.00	-	1,641.07
2	Shpenzimet logjistike	2,500.00	-	2,500.00	-	837.60
3	Energjia elektrike dhe komunal	1,750.00	27.04	1,722.96	1.55	29.44
4	Kontrollimet sistematike	750.00	-	750.00	-	-
5	Marketingu	2,250.00	130.69	2,119.31	5.81	466.53
6	Udhëtimet zyrtare	750.00	-	750.00	-	284.41
7	Telefonat dhe Posta	2,375.00	2,144.29	230.71	90.29	2,103.92
8	Shërbimet bankare	250.00	138.19	111.81	55.28	108.20
9	Tatimet	10,500.00	153.00	10,347.00	1.46	3,638.39
10	Pajisje elektronike	3,700.00	165.00	3,535.00	4.46	260.37
	TOTAL - Shpenzimet operative	26,075.00	2,758.21	23,316.79	10.58	9,369.93
E	Shpenzimet administrative					
1	Inventar dhe pajisje	2,500.00	99.00	2,401.00	3.96	54.41
2	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	7,000.00	3,114.68	3,885.32	44.50	3,114.68
3	Material i zyrës	4,375.00	120.00	4,255.00	2.74	1,682.96
4	Material sanitar	1,750.00	-	1,750.00	-	463.24
5	Qiraja për objektet	3,750.00	1,940.11	1,809.89	51.74	1,787.14
6	Reprezentacioni dhe bufeja	1,000.00	255.06	744.94	25.51	1,023.98
7	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	1,175.00	-	1,175.00	-	69,767.90
8	Shpenzimet logjistike	5,000.00	1,595.95	3,404.05	31.92	516.16
9	Kontigjente	2,500.00	-	2,500.00	-	-
	TOTAL - shpenzimet administrative	29,050.00	7,124.80	21,925.20	24.53	78,410.47
	Provizionimi i llogarive të arkëtueshme	-	-	-	-	-
II	TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)	723,000.00	359,058.79	363,941.21	49.66	570,883.81
III	Fitimi (Humbja) para zhvlerësimit	56,068.75	4,894.64	51,174.11	8.73	(148,378.49)
	GRANTET	102,500.00	120,939.12	(18,439.12)	117.99	77,509.56
F	Shpenzimet e zhvlerësimit		-			
1	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve	72,500.00	120,939.12	(48,439.12)	166.81	77,509.56
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë	30,000.00	13,217.86	16,782.14	44.06	14,409.97
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	102,500.00	134,156.98	(31,656.98)	130.88	91,919.53
G	Fitimi (humbja) nga veprimtaria	26,068.75	(8,323.22)	34,391.97	(31.93)	(162,788.46)


Tabela Nr. 3.1

Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit Prill - Qershor 2025



Diagrami Nr. 3.2

Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive Prill - Qershor 2025



Diagrami Nr.3.3

III.2. Gjendja në para të gatshme – raporti sipas bankës më 30.06.2025

Nr.	EMËRTIMI	Saldo 30.06.2025
1	PCB nr. 1114-004229-0001-59	4,941.85
2	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	0.00
3	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	1.86
4	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	0.37
5	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	0.05
6	GH-PCB nr. 1114004229040114	27.52
7	PCB nr. 1114-004229-0001-65	290,640.94
	TOTALI	295,612.59

Tabela Nr. 3.4

III.3. Transaksionet e realizuara (Prill - Qershor 2025)

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse, llogarinë e projekteve kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës dhe llogaritë rrjedhëse për subvencione:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.04.2025	6.14
Inkasimet e pranuar gjatë muajve Prill - Qershor 2025	281,503.43
Pagesat e kryera gjatë muajve Prill - Qershor 2025	276,562.72
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 30.06.2025	4,941.85

Tabela Nr. 3.5

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.04.2025	0.86
Inkasimet e pranuar gjatë muajve Prill - Qershor 2025	209,763.18
Pagesat e kryera gjatë muajve Prill - Qershor 2025	209,762.18
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 30.06.2025	1.86

Tabela Nr. 3.6

Transaksionet e kompanisë nga subvencionet (MI dhe ME) në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.04.2025	3.32
Inkasimet e pranuar gjatë muajve Prill - Qershor 2025	438,921.82
Pagesat e kryera gjatë muajve Prill - Qershor 2025	438,924.75
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 30.04.2025	0.42

Tabela Nr. 3.7

Transaksionet e kompanisë Llogaria e kursimeve FLEX në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.04.2025	189,178.94
Inkasimet e pranura gjatë muajve Prill - Qershor 2025	385,934.00
Pagesat e kryera gjatë muajve Prill - Qershor 2025	284,472.00
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 30.06.2025	290,640.94

Tabela Nr. 3.8

Në tabelën më poshtë janë paraqitur transaksionet më të mëdha gjatë periudhës prill - qershor 2025 për deponimet dhe pagesat:

Deponimet Prill - Qershor 2025			Pagesat Prill – Qershor 2025		
1	Deponim nga MMPHI	339,813.57	1	Pagat e punëtoreve	170,022.94
2	Deponim nga ME Kpaitale	130,313.18	2	Pagesa për Profitech shpk	130,319.18
3	Deponim nga ME	99,106.25	3	Pagesa për ATK	42,190.50
4	Deponim nga TU	22,006.16	4	Pagesa për HIB Petrol	53,918.46
5	Deponim nga KMDK	10,161.03	5	Pagesa për Infrakos sh.a	45,187.79
TOTALI		601,400.19	TOTALI		441,638.87

Tabela Nr. 3.8

III.4. Bilanci i Gjendjes (30.06.2025)

BILANCI I GJENDJES		
NP TRAINKOS SH.A	GJENDJA FILLESTARE 01.01.2025	GJENDJA PERFUNDIMTARE 30.06.2025
Mjetet themelore - vlera neto sipas librave	2,242,734.25	1,980,132.03
Mjetet Qarkulluese	1,012,659.08	1,214,987.08
Stoqet	420,534.77	545,553.28
Paraja	528,003.53	296,493.81
Llogarite e arketueshme	51,179.71	357,292.21
Kerkesa tjera te arketushme	3,026.72	5,054.43
Parapagimet	9,914.35	10,593.35

Total Mjetet Qarkulluese dhe Themelore	3,255,393.33	3,195,119.11
Detyrimet afatshkurta	2,117,841.31	2,187,577.55
Llogarite e pagueshme	754,837.32	739,058.85
Te pagueshme tjera - detyrime	558.44	88,108.68
Detyrime tatimore	997,482.55	995,447.02
Detyrimet e kredisë	364,963.00	364,963.00
Detyrimet afatgjata	1,554,696.31	1,443,131.25
Kapitali	5,294,036.25	5,293,266.85
Fitimi/Humbja e bartur	-5,222,550.72	-5,745,527.62
Fitim/ Humbja e vitit	-488,629.86	16,671.08
Total detyrimet dhe kaptali	3,255,393.32	3,195,119.11

Tabela Nr. 3.9

IV. TRANSPORTI I UDHËTARËVE

IV.1 Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TU

Gjatë periudhës **Prill – Qershor 2025/ numri** i përgjithshëm i udhëtarëve të transportuar është **23,250** ndërsa shuma e të hyrave nga shitja e biletave dhe ID kartelat është **23,899.0** me TVSH dhe **20.253.37€** pa TVSH. Krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit **2024**, numri i udhëtarëve në **TM2 2025 është për 4846** udhëtarë më shumë, shprehur në përqindje **26.33 %**, më shumë. Krahasuar me planifikimin, numri i udhëtarëve të transportuar është për **772** udhëtarë më shumë, shprehur në përqindje, + **3.43%**. Ndërsa, realizimi financiar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është për **5,193.47 €** më shumë, apo + **34.49 %**, ndërsa krahasuar me planifikimin, të hyrat për këtë periudhë raportuese janë për + **5,253.37 €** më shumë, apo shprehur në përqindje + **29.19 %**.

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim në formë tabelore performancën operative dhe financiare në transportin e udhëtarëve për periudhën **Prill - Qershor 2025** si dhe të dhënat krahasuese me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, dhe planifikimin për periudhën raportuese në **TM2 2025**:

Sqarim : në numrin total të udhëtarëve nuk janë të përfshira kategoritë e liruar nga pagesa, këto kategori nuk paguajnë biletë ,mirëpo janë kategori të cilat frekuentojnë mjaft shumë transportin hekurudhorë.

Të dhënat për numrin e udhëtarëve për periudhën TM2 2025							
Përshkrimi	Realizim TM2 2024	Realizimi TM2 2025	Planifikim TM2 2025	Dallimi: Realizim TM2 2025 – TM2 2024	Dallimi: Realizim - planifikim m TM2 2025	Dallimi në %: TM2 2025 – TM2 2024	Dallimi në %: Realizim - planifikim TM2 2025
Prill-Qershor	18 404	23 250	22 500	+ 4846	+ 772	+ 26.33 %	+ 3.43 %

Tabela Nr. 4.1

Të dhënat për realizimin financiar në transportin e udhëtarëve për periudhën TM2 2025							
Përshkrimi	Realizimi TM2 2024	Realizimi TM2 2025	Planifikimi TM2 2025	Dallimi: Realizim TM2 2025 – TM2 2024	Dallimi: Realizim - planifikim TM2 2025	Dallimi në %: TM2 2025 – TM2 2024	Dallimi në %: Realizim - planifikim TM2 2025
Prill-Qershor	15,059.97	20,253.9	18000	+5,193.47	+5,253.37	+34.49%	+ 29.19%

Tabela Nr. 4.2

Siç shihet nga të dhënat e paraqitura më sipër, gjatë kësaj periudhe kohore është shënuar një rritje në numrin e udhëtarëve krahasuar si me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ashtu edhe me planifikimin.

IV.2 Numri i trenave, tren kilometër (t/km) dhe udhëtarë kilometër (u/km)

Të dhënat për transportin e udhëtarëve për periudhën tremujore:

- Numri i trenave të udhëtarëve: 536
- Numri i përgjithshëm i udhëtarëve për kilometer (udhëtar/km): 821,609.49
- Totali i kilometrave të zhvilluara nga trenat e udhëtarëve (tren/km): 32,908.4
- Shpejtësia mesatare operationale (V/kom): 42.303 km/h

Analizë e të dhënave për transportin e udhëtarëve – periudha tremujore

Gjatë kësaj periudhe tremujore, janë realizuar gjithsej **536 trena** të udhëtarëve, duke përshkruar një distancë totale prej **32,908.4** kilometrash (tren/km). Numri i përgjithshëm i udhëtarëve për

kilometër (udhëtar/km) ka arritur në **821,609.49**, çka tregon një shfrytëzim relativisht të mirë të kapaciteteve transportuese për këtë periudhë.

Shpejtësia mesatare operationale ka qenë **42.303 km/h**, që tregon për një efikasitet të moderuar të lëvizjes së trenave, duke marrë parasysh infrastrukturën ekzistuese dhe kushtet operative.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar dhe me planifikimin fillestar:

- Numri i trenave dhe kilometrat e zhvilluara kanë pasur një trend rritës, duke reflektuar një përmirësim në ofrimin e shërbimeve të transportit.
- Rritja në udhëtar/km tregon një kërkesë në rritje për shërbimet hekurudhore, gjë që mund të lidhet me faktorë si përmirësimi i cilësisë së shërbimit, rritja e besueshmërisë apo ndryshimet në preferencat e udhëtimit të qytetarëve.

Rekomandim:

Nëse ky trend pozitiv vijon, do të ishte e udhës të vlerësohet mundësia për rritjen e frekuencës së linjave më të kërkuara, si dhe të bëhen investime të mëtejshme në Tërheqës dhe te Tërhiqia për të përmirësuar më tej shpejtësinë dhe komoditetin e udhëtimit.

IV.3 Vonesat e trenave të udhëtarëve

Të dhëna përmbledhëse për vonesat e trenave (nga gjithsej 536 trena):

Shkaku i vonesave	Minuta	Në përqindje (%)
Lokomotiva HM	0	0
Vazhdimi i udhëtimit	0	0
Kryqëzimet	0	0
Lokomotiva/GM defekt	0	0
Lidhja me trenin	0	0
Bashkëngjitja e vagonëve/tërheqja e mjeteve	0	0
Doganë + Polici	0	0
Pritje në garniturë	0	0
Aksidente	0	0
Në nisje	430	11.38%
Në arritje	3350	88.62%
Të tjera	0	0
Total vonesat	3780	100%

Tabela Nr. 4.3

Pikat kryesore të analizës:

Shumica dërrmuese e vonesave (88.62%) kanë ndodhur në arritje, që nënkupton se trenat janë nisur në kohë, por janë vonuar gjatë rrugës ose në stacionin përfundimtar.

Vonesat në nisje përbëjnë vetëm 11.38%, që tregon menaxhim relativisht të mirë në pikën e nisjes.

Të gjitha kategoritë e tjera kanë zero minuta vonesë, që sugjeron ose një periudhë me operim të qetë, ose që mund të mos jenë dokumentuar me vonesa për këtë periudhë specifike.

Mesatarja e vonesës për tren:

3780 minuta

7.05 minuta për tren

563 trena

V. TRANSPORTI I MALLRAVE

V.1 Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TM

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim indikatorët fizikë të performancës operative në transportin e mallrave për periudhën prill – qershor 2025 si dhe do të behët krahasimi me planifikimin dhe me realizimin për periudhën e njëjtë të vitit 2024.

Gjatë periudhës prill – qershor 2025 nuk është realizuar fare transport ,krahasuar me priudhën e njëjtë raportuse të vitit 2024 ,në TM-2 janë transportuar 710, neto-tonë mallra, ndërsa shuma e të hyrave nga ky transport ka qenë 4,700 €. Mirëpo ,nëse krahasojmë realizimin me planifikim periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2025, në TM-2 , nuk është realizuar asnjë transport,pra 0.00% e planifikimit ,ndërsa ne TM-2,2024 janë -129,290 neto ton mallra më pak të transportuera apo shprehur në përqindje është realizuar vetëm 0.55% e planifikimit.Ndërsa realizimi financiar krahasuar me periudhen e njëjtë tëvitit të kaluar është 0.00€, apo shprehur në përqindje,0.00% ndërsa, krahasuar me planifikim janë -256,000.00 €, apo shprehur në pëqindje 0.00%,të realizimit financiar të parashikuar.

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim në formë tabelore dhe përmes diagrameve performancën operative dhe financiare në transportin e mallrave për periudhën prill - qershor 2025 si dhe të dhënat krahasuese me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar si dhe me planifikimin për periudhën raportuese në TM2 2025.

Realizimi në transportin e mallrave:

Prill - Qershor 2025	Realizimi Neto Ton 2024	Realizimi Neto Ton 2025	Planifikimi Neto Ton 2025	Dallimi Realizim 2025/2024	Dallimi Realizim-Planifikim 2025	Dallimi Realizim 2025/2024 (%)	Dallimi Realizim-Planifikim 2025(%)
Sasia e transportuar	7,103	0.00	110,000	0.00	-110,000	0.00%	0.00%

Tabela 5.1

Siç mund të shihet nga tabela 5.1, transporti nuk është realizuar 0.00% të planifikimit.

Transporti i mallrave me kontejnerë për periudhën prill - qershor 2025 ka qenë:

Numri i transportuar i kontejnerëve	Kontejnerë të plotë 2025	Kontejnerë të zbrazët 2025
Sasia	0.00	0.00

Tabela 5.2

Sasia e transportuar në neto-ton për periudhën prill – qershor 2025 në formë diagrami:




Figura 5.1

Siç mund të shihet nga figura 5.1 në aspektin operativ nuk kemi arritur të realizojmë transportin e planifikuar për periudhën prill - qershor 2025.

Të hyrat nga transporti i mallrave për periudhën raportuese janë:

Të hyrat Prill - Qershor 2025	Realizim shitje të hyra 2024	Realizim shitje të hyra 2025	Planifikim 2025	Dallimi në Realizim 2025/2024	Realizim-Planifikim 2024	Realizim 2025/2024 (%)	Realizim-Planifikim 2025 (%)
Vlera €	4,700	0.00	256,000.00	0.00	-256,000.00	0.00%	0.00%

Tabela 5.3

Siç mund të shihet nga tabela më lart, të hyra nuk kemi pasur, nuk kemi arritur të realizojmë transportin e planifikuar për periudhën prill - qershor 2025.

Të hyrat në periudhën Prill - Qershor 2025 në formë diagrami:




Figura 5.2

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i mallrave:

Të hyrat dhe shpenzimet	Shitjet/të hyrat në TM	Të ardhura tjera nga TM	Total shitjet	Shpenzimet direkte në TM	Shpenzi met indirekte në TM	Total Shpenzimet	Fitimi/humbja operative	Fitimi/humbja në %
Vlera €	0.00	1,525.42	1,525.42	67,524.52	518.00	67,006.52	(65,481.10)	-42.93

Tabela 5.4

Transporti i Mallrave në kostot indirekte ka marrë 1.59% të shpenzimeve në total të kompanisë kjo vjen nga ndarja e shpenzimeve me transportin e udhëtarëve në bazë të përqindjes së marrjes pjesë me trena (*tren kilometër*) në komunikacion.

V.2 Shfrytëzimi i trenave

Për shkak të punimeve në Linjën e 10-të Hekurudhore, në relacionin Fushë Kosovë - Hani i Elezit, linja ka qenë e mbyllur gjatë gjithë kohës, Ndërsa, transporti vendor nuk është realizuar sipas planifikimeve, për shkak të mos fillimit të transportit të xehes nga Ferronikeli.

Prill – Qershor 2025	Trena të planifikuar	Trena të shfrytëzuar	Shfrytëzim/Planifikim në % 2025
Import	0	0	0.00 %
Export	0	0	0.00 %
Vendor	228	0	0.00 %
Total	228	0	0.00 %

Tabela 5.5

V.3 Efektiviteti i trenave

Prill – Qershor 2025	Pesha max. bartëse t/tren	Mesatarja e çdo treni - bt	Efektiviteti (%)
Import	1200	0.00	0.00 %
Eksport	1200	0.00	0.00 %
Vendor	1400	0.00	0.00 %

Tabela 5.6

V.4 Neto-ton & neto-ton kilometër të transportuar

Neto ton	Realizim Prill – Qershor 2025	Planifikim Prill - Qershor 2025	Realizim/Planifikim 2025 në %	Neto ton kilometër	Humbje Planifikim/Realizim 2025 (ton)
Import	0	0.00	0.00 %	0.00	0.00
Export	0	0.00	0.00 %	0.00	0.00
Vendor	0	110,000	0.00 %	0.00	-110,000
Total	0	110,000	0.00 %	0.00	-110,000

Tabela 5.7

V.5 Revokimi i trenave

Gjatë periudhës prill - qershor 2025 ka pasur revokime të trenave të planifikuara, të cilat pasqyrohen në tabelën në vijim sipas kategorive të ndara në transportin ndërkombëtar (import-export) dhe transport vendor:

Prill - Qershor 2025	Trena të revokuar me 0%	Trena të revokuar me 10%	Trena të revokuar me 20%	Trena të revokuar me 100%	Vlera në euro e revokimeve
Import-Export	78	0	0	0	0.00 €
Vendor	0.00	228	0	0	0.00 €
Total	78	228	0	0	999.78 €

Tabela 5.8

Organizimi i tërheqjes me lokomotiva dhe manovruese – shpenzimet e naftës dhe kilometrat e kaluara

Shpenzimet e lokomotivave tërheqëse dhe manovruese -Transporti i mallrave Prill - Qershor 2025							
Muaji	Shp./km	2640-007	2640-008	2710-009	2640-010	2760-001	Totali
Prill	Shp.Naftë	0.00	0.00	0.00	0,00	0,00	0.00
	Kilometrat	0.00	4	0.00	0,00	33	37
	Nafta /km	0.00	0.00	0.00	0,00	0,00	0.00
Maj	Shp.Naftë	0.00	2,920	0.00	0,00	191	3,111
	Kilometrat	0.00	200	0.00	0,00	61	261
	Nafta /km	0.00	14.60	0.00	0,00	3,13	11.91
Qershor	Shp.Naftë	0.00	0.00	0.00	0,00	260	260
	Kilometrat	0.00	188	0.00	0,00	32	220
	Nafta /km	0.00	0.00	0.00	0,00	8,12	1.18
Prill – Qershor 2025	Shp.Naftë	0.00	2,920	0.00	0,00	451	3,371
	Kilometrat	0.00	392	0.00	0,00	126	518
	Nafta /km	0.00	7.44	0.00	0,00	3.58	6.50

Tabela 5.9

VI. MIRËMBAJTJA E MJETEVE LËVIZËSE -MML

VI.1 Pasqyra e performancës operative

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën gjatë periudhës 01.Prill – 30 Qershor 2025, duke krahasuar me realizimin e tre mujorin të parë (TM2) të vitit 2024.

VI.2 Sektori i mirëmbajtjes

Në Zyrën e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse përfshihen: Mirëmbajtja e trenave motorik, mirëmbajtja e lokomotivave transportuese, mirëmbajtja e lokomotivave manovruese, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtareve, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave dhe punë të tjera për riparimin e vagonëve të huaj.

VI.3 Mirëmbajtja e trenave motorik

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e trenave motorik të realizuara ne periudhën Prill- Qershor 2025 krahasuar me periudhën Prill- Qershor 2024:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Janar- Mars 2025	Janar- Mars 2024	Ndryshimi
1.	Servisime	0	0	0
2.	Riparime	0	0	0
3.	Kontrollime K1	0	0	0
4.	Kontrollime K6	0	0	0

Tabela 6.1

VI.4 Mirëmbajtja e Lokomotivave Transportuese

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Janar-Mars 2025	Janar-Mars 2024	Ndryshimi
1.	Servisime	86	95	-9
2.	Riparime	6	10	-4
3.	Kontrollime K1	7	6	+1
4.	Kontrollime K3	1	1	0
5.	Kontrollime K6	2	3	-1
6.	Gdhendja e rrotave	0	0	0

Tabela 6.2

VI.5 Mirëmbajtja e Lokomotivave Manovruese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave manovruese të realizuara në periudhën Prill- Qershor 2025 krahasuar me periudhën Prill- Qershor 2024:

	Lloji i Riparimit/Mirëmbajtjes	Prill - Qershor 2025	Prill – Qershor 2024	Ndryshimi
1.	Servisime	1	0	+1
2.	Riparime	1	0	+1
3.	Kontrollime K1	2	0	+2
4.	Kontrollime K3	1	0	+1
5.	Kontrollime K6	0	0	0

Tabela 6.3

VI.6 Intervenimet në mjetet tërheqëse

Intervenimet në mjetet tërheqëse gjatë periudhës tre mujore (Prill – Qershor 2025) për secilin mjet tërheqës është dhënë në tabelën në vazhdim:

Mjetet tërheqëse (Nr.)	2620 005	2640 007	2640 008	2710 009	2640 010	2620 016	2760 001	2760 002	5800 004
Servisime (S)	70	0	1	0	0	15	1	0	0
Riparime (R)	1	0	2	0	0	3	1	0	0
Kontrollime (K 1)	2	2	2	0	0	1	2	0	0
Kontrollime (K 3)	0	1	0	0	0	0	1	0	0
Kontrollime (K 6)	1	0	1	0	0	0	0	0	0
Gdhendje të rrotave	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 6.4

Servisime – S

Riparime – R

Kontrollime njëmuajor – K1

Kontrollime tremujor – K3

Kontrollime gjashtëmuajor – K6

VI.7 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtareve

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të udhëtareve realizuar në periudhën Prill- Qershor 2025, krahasuar me periudhën Prill- Qershor 2024:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Prill – Qershor 2025	Prill – Qershor 2024	Ndryshimi
1.	Kontrollime (K1)	11	12	-1
2.	Riparim në punëtori	9	15	-6
3.	Gdhendje të rrotave	1	3	-2
4.	Testim i komponentëve	0	0	0
5.	Riparime në stacion	0	0	0

Tabela 6.5

IV.8 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave të realizuar në periudhën Prill- Qershor 2025, krahasuar me periudhën Prill- Qershor 2024:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Prill - Qershor 2025	Prill - Qershor 2024	Ndryshimi
1.	Kontrollime K3	0	0	0
2.	Riparim në punëtori	0	0	0
3.	Riparim në teren	0	0	0
4.	Gdhendje të rrotave	0	0	0

Tabela 6.6

VI.9 Riparimi i vagonëve të huaj

Gjatë këtij tre mujori, Zyra e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse nuk ka pasur kërkesa për riparim të vagonëve të huaj.

Në tabelën nr.6.7, janë paraqitur vlerat e punëve të kryera për periodën Prill- Qershor 2025 dhe është krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024:

Riparimi/mirëmbajtja e vagonëve të huaj	Prill - Qershor 2025	Prill – Qershor 2024
NewCo Ferronikeli	00.00 €	00.00 €

Tabela 6.7

VII. PROJEKTET DHE PROKURIMI

VII.1 Projektet Kapitale

Në tabelën 7.1 janë paraqitur projektet të cilat janë zhvilluar gjatë periudhës prill – qershor 2025:

Nr	Titulli i Aktivitetit të Prokurimit	Data e nënshkrimit	Vlera e parashikuar	Vlera e kontratës	Koment
1	Shërbimet e abonimit të arkave fiskale	Shkurt 2024	4,319.98	4,319.98	Në implementim
2	Shërbimet e mirëmbajtjes së sistemit financiar PLANET Accounting	Janar 2024	10,800.00	10,800.00	Ne implementim
3	Shërbimet e Auditimit të pasqyrave Financiare për vitin 2023, 2024, 2025	Dhjetor 2023	9,500.00	7,839.97	Në implementim
4	Furnizimi me modul kontrollë për diesel motor të tipit 8-710G3B-2		12,000.00	9,971.00	Kontraktuar
5	Furnizimi me pajisje dhe pjese rezerve për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse (Furnizim me filtra për lokomotiva)	Mars	16,000.00	15,147.36	Përfunduar
6	Furnizimi me pajisje dhe pjese rezerve për MML II (Furnizimi me xhama për vagonë të udhëtareve)	Shkurt	14,000.00	13,196.47	Përfunduar
7	Furnizimi me modul për lokomotivën G1700	Maj	6,500.00	6,485.28	Kontraktuar
8	Furnizim me modul TH14 për lokomotivën GM 645	Shkurt	7,500.00	4,472.20	Përfunduar
9	Furnizimi me laptop për nevoja të Bordit të Drejtoreve të Trainkos Sha	Janar	2,400.00	1,090.00	Përfunduar
10	Riparimi i frenueseve indirekte Westinghouse 26C për lokomotivën GM G16 (661)	Mars	6,500.00	6,431.00	Kontraktuar

11	Furnizimi me material Higjienik	Mars	50000	1,482.73	Ne proceduare
12	Furnizimi me brusha për lokomotivën 645	Maj	3,800.00	2,478.00	Përfunduar
13	Furnizimi me materiale administrative	Shkurt	3,300.00	2,444.02	Kontraktuar
14	Furnizimi me toner për nevoja te Trainkos Sha	Mars	1,400.00	1,299.01	Kontraktuar
15	Riparimi i mesëm i vagonëve të transportit të udhëtarëve		365,420.00		Ne vlerësim
16	Ndërrimi i rrotave për lokomotivën 645 016	Maj	100,000.00	97.309.51	Kontraktuar
17	Rregullimi i Automjetit Hyundai X35	Qershor	850.00	916.00	Kontraktuar
18	Furnizimi me fshesë elektrike për pastrimin e vagonëve	-----	500.00		Anuluar
19	Furnizimi me injektor për motor 645 E3 te lokomotivave GT22HW-2	Shkurt	7,000.00	6,159.60	Përfunduar
20	Shërbimet e sigurimit të palëve të treta	Maj	2,000.00	1,982.40	Kontraktuar
21	Furnizim me klime 18 she	Maj	650	650	Kontraktuar
22	Furnizimi me printer skaner 4ne1	Maj	260	260	Kontraktuar
23	Furnizimi me ujë të pijshëm në bidon 10 L	Qershor	990	900	Kontraktuar
24	Matja e Kënaqshmërisë së Klientëve në Transportin e Mallrave dhe të Udhëtarëve	Qershor	870	844	Kontraktuar

1. Shërbimet e abonimit te arkave fiskale - projekti është kontraktuar dhe është ne zbatim.
2. Shërbimet e mirëmbajtjes se sistemit financiar PLANET Accounting- është nënshkrua kontrata me datën 10.01.2024 dhe është projekt për 3 vite është procedurë e negociuar pa publik

3. Shërbimet e Auditimit të pasqyrave Financiare për vitin 2023, 2024, 2025 - Projekti është kontraktuar për periudhe trevjeçarë dhe është në zbatim e sipër. Operatori Ekonomik ka përfunduar pjesën e dytë të kontratës për auditim të pasqyrave financiare për vitin 2024 dhe e njëjta është faturuar.
4. Furnizimi me modul kontrolle për diesel motor të tipit 8-710G3B-2 – kemi pranuar dy oferta dhe jeni në fazën e kontraktimit me operatorin TOREX GROUP L.L.C
5. Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezerve për mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse (Furnizim me filtra për lokomotiva)- është dërguar edhe shuma e fundit për pagë të dhënë janë bërë ndalesat administrative për vonesa nga operatori E.K.
6. Furnizimi me pajisje dhe pjesë rezerve për MML II (Furnizimi me xhama për vagonë të udhëtarëve)- projekti ka përfunduar dhe është pranuar faktuar është dërguar për pagë
7. Furnizimi me modul për lokomotivën G1700- projekti është përsëritur dhe kemi nënshkruar kontratën me O.E Profitech SH.P.K
8. Furnizim me modul TH14 për lokomotivën GM 645 – është pranuar nga komisioni teknik dhe faktuar është dërguar për pagë
9. Furnizimi me laptop për nevojat e Bordit të Drejtoreve të Trainkos Sha – është pranuar nga komisioni teknik dhe faktuar është dërguar për pagë
10. Riparimi i frenuesve indirekte Westinghouse 26C për lokomotivën GM G16 (661)- është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik RM In Time L.L.C. me çmime 6,431.00
11. Furnizimi me material Higjienik - është shpall oferta fituese me të cilën është nënshkruar kontrata me O.E. PM GROUP SH.P.K. me çmime 1,482.73
12. Furnizimi me brusha për lokomotivën 645 – është bërë hapja e tenderit kemi pranuar 8 oferta, komisioni i vlerësimit ka marr ofertat për vlerësim. Është nënshkruar kontrate me O.E. GETNO L.L.C. në vlerë 2,478.00. projekti ka përfunduar pasi është bërë liferomi i mallit sipas afatit, është shkruar për pagë.
13. Furnizimi me materiale administrative - është nënshkruar kontrata me Operatorin Ekonomik me vlerë prej 2,444.02
14. Furnizimi me toner për nevojat e Trainkos Sha - është nënshkruar kontrata me Operatorin Ekonomik me vlerë 1,299.01
15. Riparimi i mesëm i vagonëve të transportit të udhëtarëve - është bërë hapja e ofertave, komisioni i vlerësimit ka marr ofertën për vlerësim
16. Ndërrimi i rrotave për lokomotivën 645 016 – është nënshkruar kontrata me Operatorin Ekonomik Profitech me vlerë prej 97,309.51.
17. Rregullimi i Automjetit Hyundai X35 - është bërë hapja e tenderit dhe kemi pranuar një ofertë nga NTP Auto Bosch me çmime prej 916.00. Projekti ka përfunduar
18. Furnizimi me fshesë elektrike për pastrimin e vagonëve – ky projekt tenderohet që dy herë dhe nuk kemi marr asnjë ofertë.
19. Furnizimi me injektor për motor 645 E3 të lokomotivave GT22HW-2 - projekti është pranuar nga komisioni i pranimit teknik dhe faktuar është dërguar për pagë
20. Shërbimet e sigurimit të palëve të treta është nënshkruar kontrata me O.E.

21. Furnizim me klime 18-she- kemi pranuar një oferte dhe njëjta është shpallur fituese.
22. Furnizimi me printer skaner 4ne1 - projekti ka përfunduar faktuara është dërguar për pagese
23. Furnizimi me ujë të pijshëm në bidon 10 L – kemi pranuar një oferta nga Ujë Rogove ShPK dhe kemi shpallur fitues. Ku çmimi për bidonë është 1.5 euro
24. Matja e Kënaqshmërisë së Klientëve në Transportin e Mallrave dhe të Udhëtareve – kemi pranuar dy ofertues, ofertuesi UBT me ofertën me te lire me çmimi 844.00 është shpallur fituesi.

VIII. KONTESTET LIGJORE

Gjatë periudhës prill–qershor 2025, zyra ligjore e ndërmarrjes ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përfaqësim sa më të denjë dhe efikas në çështjet ligjore pranë institucioneve përkatëse të Republikës së Kosovës. Gjatë tremujorit të dytë të vitit, në Gjykatat Themelore dhe Komerciale janë mbajtur gjithsej nëntë seanca gjyqësore lidhur me procese gjyqësore ku ndërmarrja ka qenë palë në procedurë, në cilësinë e paditëses apo të paditurës. Në këtë periudhë, ndërmarrja është përballur dhe ka ndërmarrë veprime procedurale në shtatë konteste për kompensim dëmi, dy konteste të natyrës së marrëdhënies së punës, një çështje për pagim borxhi, një çështje penale, si dhe një rast me aktvendim për korrigjimin e numrit të lëndës në aktgjykimin e Gjykatës Komerciale në Prishtinë, pa ndryshuar përmbajtjen tjetër të aktgjykimin. Po ashtu, gjatë këtij tremujori, kemi pranuar një aktvendim nga Gjykata Supreme e Kosovës, me të cilin është hedhur si i palejuar revizioni i paditësit dhe lënda është përmbyllur në favor të Kompanisë Trainkos Sh.A., një aktvendim nga Gjykata Themelore në Pejë, me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, duke përfunduar gjithashtu në favor të Kompanisë Trainkos Sh.A., një aktvendim nga Gjykata e Apelit e Kosovës, ku është aprovuar ankesa e të paditurës Trainkos Sh.A. dhe lënda është kthyer në rigjykim; një aktvendim për përgjigje në padi nga Gjykata Themelore në Glllogoc; si dhe një aktvendim nga Gjykata e Apelit në Prishtinë, me të cilin refuzohet ankesa e të paditurës Trainkos Sh.A. Gjatë kësaj periudhe është realizuar edhe një plotësim i ekspertizës financiare. Ndërmarrja ka pranuar gjithashtu një ankesë kundër Gjykatës Komerciale të Kosovës dhe një ankesë kundër Gjykatës Themelore në Pejë. Po ashtu, janë parashtruar një ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë dhe një përgjigje në padi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

VIII.1 KONTESTET GJYQËSORE PËR VITIN 2025

Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A., në vitin 2025, pritet të ballafaqohen me **61** konteste gjyqësore, që do të thotë kemi pasur ndryshime në këtë tre mujor disa lëndë kanë përfunduar dhe kemi pranuar padi të reja. Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve dhe kategorizimi i tyre për të cilat mund të zhvillohen veprime procedurale te përshkruar sipas aktivitetit ne tabelën e mësipërme:

Nr.	LLOJET E KONTESTEVE	
1.	Kontestet e marrëdhënies së punës	12
2.	Kontestet për kompensim të dëmit	24
3.	Kontestet për pagimin e borxhit	4
4.	Kontest nga Konflikti Administrativ	1
5.	Lëndë në procedurë përmbarimore	19
6.	Lëndë në procedurë penale	1
7.	Totali	61

IX. AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT

IX.1 Planifikimi dhe Zhvillimi i Biznesit

Përkundër vazhdimësisë në realizimin e të hyrave nga Marrëveshja e OShP-së (2023 – 2027) për vitin 2025, transporti i planifikuar nga shërbimet për mallra nuk ka ndodhur. Edhe për këtë periudhë ashtu si në pjesën e fundvitit 2024 janë vonesat e përfundimit të punëve që janë duke u zhvilluar në modernizimin e Linjës së 10-të Hekurudhore. Nëse e kemi parasysh se Linja e 10-të hekurudhore është arteria bazë e rrjetit hekurudhorë në dhe nga Kosova atëherë kjo është pengesë esenciale në zhvillimin e biznesit të kompanisë për transport me hekurudhë dhe realizimin e projekteve tjera po ashtu shumë esenciale për të ardhmen. Pritjet tona që Linja të lëshohet në shfrytëzim sipas orareve të paralajmëruara nuk kanë ndodhur, nga kjo vazhdon mosplotësimi i planifikimeve tona për transportin e mallrave dhe udhëtarëve sipas planifikimeve dhe kërkesave që dalin për sektorin hekurudhor nga planifikimet dhe strategjitë e shtetit të Kosovës.

IX.2 Aktivitetet në transportin e mallrave përgjatë periudhës Prill – Qershor 2025

Nga klientët vendorë, me të cilët kemi pasur të nënshkruar aneks kontratë për transport deri më 31.12.2023 ka qenë vetëm një, klienti nuk ka vazhduar kontratën gjatë vitit 2025:

Nr.	Emri i kompanisë	Vendi	Mallrat që transporton
1	NewCo Ferronikeli	Drenas	Xehe të nikelit dhe thëngjill.

Klientët/Partnerët të cilët kanë nënshkruar kontratë transporti me Trainkos Sh.A. për vitin 2025 janë gjithsej tre (3) partnerë. Duhet theksuar se këta partnerë që kanë nënshkruar kontratë transporti janë ndërkombëtarë, të njëjtit kanë pasur kontratë të nënshkruar edhe në vitin 2023, përjashtimisht klienti/partneri **Schenker DB dhe Fershped AD**.

Lista e partnerëve ndërkombëtarë:

Nr	Emri i kompanisë	Vendi	Mallrat që transporton
1	NAVICO SHIPPING DOO	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
2	CARGO LOGISTC DOO	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
3	ARGO LOGISTIC INT	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet

IX.3 Aktivitetet në fushën promovuese gjatë periudhës Prill – Qershor 2025

Përveç aktiviteteve të sipërpërmendura Sektori i Marketingut kryen edhe aktivitete të tjera në fushën promovuese dhe menaxhon buxhetin e shpenzimeve të Sektorit të Marketingut për promovimin e shërbimeve të Trainkos Sh.A. përmes kanaleve të ndryshme të marketingut. Sektori i Marketingut ka qenë gjithmonë në përcjellje të organizimeve grupore të cilat janë aprovuar dhe janë realizuar me vagonë të udhëtarëve, nëpërmjet kërkesave të veçanta për shfrytëzimin e aseteve të Trainkos Sh.A. Po ashtu, gjatë tërë kohës mbajmë kontakte me udhëtar aktual dhe potencial të cilët bëjnë pyetje nëpër rrjetet sociale.

Kërkesat që kemi pasur për shfrytëzim të aseteve, shërbimeve të veçanta gjatë periudhës Prill – Qershor 2025 janë si në vijim:

Nr.	Data e shfrytëzimit	Institucioni	Lloji i Shfrytëzimit
1	17.04.2025	Klan Kosova	Kronik televizive lihur me eksperiencat e makinistëve të Trainkos SHA
2	26.04.2025	Shkolla fillore “Gjergj Fishta” Jagode	Vizitë –Udhëtim me tren në relacion Shengjergj-Prishtinë-Shengjergj
3	29.04.2025	Kopshti “Filizat” Prishtinë	Vizitë –Udhëtim me tren në relacion Prishtinë-Fushë Kosovë
4	07.05.2025	Shkolla fillore “ Fan S Noli” Podujevë	Vizitë –Udhëtim me tren në relacion FushëKosovë-Pejë-FushëKosovë

5	13.05.2025	Shkolla fillore "Mihail Grameno" FushëKosovë gr.1	Vizitë –Udhëtim me tren në relacion FushëKosovë-Pejë-FushëKosovë
6	13.05.2025	Kopshti "Nëna Kabrini" Prizren	
7	14.05.2025	Shkolla fillore "Mihail Grameno" FushëKosovë gr.2	Vizitë –Udhëtim me tren në relacion FushëKosovë-Pejë-FushëKosovë
8	15.05.2025	Kopshti "Hello Kids" Fushë Kosovë	Vizitë –Udhëtim me tren në relacion FushëKosovë-Pejë-FushëKosovë
9	15.05.2025	Shkolla fillore "Mihail Grameno" FushëKosovë gr.3	Vizitë –Udhëtim me tren në relacion FushëKosovë-Pejë-FushëKosovë
10	16.05.2025	Shkolla fillore "Mihail Grameno" FushëKosovë gr.4	Vizitë –Udhëtim me tren në relacion FushëKosovë-Pejë-FushëKosovë
11	17.05.2025	Shkolla fillore "Rilindja" Dritan	Vizitë –Udhëtim me tren në relacion Dritan-Pejë-Dritan
12	20.05.2025	Shkolla fillore "Hilmi Rakovica" Prishtinë	Vizitë –Udhëtim me tren në relacion Prishtinë-Fushë Kosovë
13	22.05.2025	Shkolla fillore "Daut Bogujevci" Fushë Kosovë	Vizitë –Udhëtim me tren në relacion Fushë Kosovë-Pejë-Fushë Kosovë
14	30.05.2025	Kopshti Ip "Ardhmeria 1" Gjilan	Vizitë –Udhëtim me tren në relacion Prishtinë-Fushë Kosovë
15	02.06.2025	Kopshti IP "Hareja" Prishtinë	
16	02.06.2025	Shkolla fillore "Ali Kelmendi" Vushtri	Vizitë –Udhëtim me tren në relacion FushëKosovë-Pejë-FushëKosovë
17	19.06.2025	Studenti nga UP –Dardan Kabashi	Xhirime te filmit " Pasqyrë" – Shfrytëzimi i reflektorëve të Trainkos SH.A gjatë xhirimit

IX.4 Bashkëpunimi me hekurudhat e vendeve tjera

Vazhdon të mbetet pengesë gjendja aktuale e linjave hekurudhore brenda vendit dhe lidhja me hekurudhat e shteteve në regjion për zhvillimin e biznesit të ndërmarrjes. Vonesat në përfundimin e projekteve për modernizimin e linjave hekurudhore pamundëson edhe shfrytëzimin e potencialit nga Portet Detare dhe Linjave tjera hekurudhore që mundësojnë transportin me hekurudhë me pjesën tjetër të Evropës dhe Botës. Kjo argumenton urgjencën e nevojës për modernizimin e Linjës së 10-të hekurudhore për të treguar një vazhdimësi në transportin hekurudhorë brenda dhe jashtë vendit. Koordinimi i proceseve dhe përfundimi i projekteve të filluara infrastrukturore mundëson vazhdimin e realizimit të projekteve tjera sipas prioriteteve të përcaktuara dhe mundësive financiare që krijohen.

Vazhdon bashkëpunimi me Hekurudhat Maqedone – Transporti në lehtësimin e procedurave për bartjen dhe transportin e Lokomotivës Ambasadore Di3.619 për Augsburg (Gjermani), janë marrë veprimet e kërkuara që kanë të bëjnë me procedura të parapëlqyera që ky transport të realizohet më në fund.

Riparimi i mjeteve lëvizëse mbetet problematikë nëse e kemi parasysh specifikën e tyre në posedim por edhe mungesën e punëtorive adekuate dhe të licencuara në regjion. Nga shteti fqinjë Maqedonia e Veriut, konkretisht punëtorja "Kolska Veles" kemi pranuar informatën se është privatizuar nga investitorë nga Italia. Kjo informatë është premtuese nëse e kemi parasysh nevojat

e përhershme për këtë shërbim, distancën e shkurtër për transport dhe ofertat që mund të i marrim në të ardhme e afërt për këto shërbime. Për këtë edhe është organizuar një vizitë nga ana e ndërmarrjes që të shohim progresin dhe planet e investitorëve për të ardhmen.

IX.5 Pjesëmarrja e Trainkos-it në iniciativat e BE-së për reforma në transportin hekurudhor përmes Lëvizshmërisë së Qëndrueshme

Në periudhën raportuese janë bërë përgatitjet dhe mbajtja e takimeve dhe kongresit për Lëvizjen Digjitale dhe SIT të organizuar nga Sekretariati për zbatimin e Traktatit për Transport në Sevilla mbështetur nga DG MOVE. Sipas rëndësisë edhe janë bërë përgatitjet e nevojshme, kjo sipas agjendës dhe mundësisë për pjesëmarrje aktive dhe përfitim nga kjo mundësi. Është bërë koordinimi i nevojshëm me pjesëmarrësit tjerë nga MMPHI-ja të cilët janë bartës të politikave të SIT dhe pjesë e transportit tjetër tokësorë në realizimin e konceptit të Transportit Multi Modal. Rugëtimi dhe mbajtja e takimeve sipas agjendës kanë qenë nga 19.05-22.05.2025 në Sevilla. Fillimisht është mbajtur kongresi për Lëvizjen Digjitale dhe SIT (20.05.2025) me përfaqësues së fushës dhe ekspert që prezantonin eksperiencën që mund të hynë në shërbim shteteve të WB6. Përvojat mundësojnë trasimin e rrugës që këto shtete duhet të e kalojnë për të arritur objektivat e parashtruara nga BE, sipas fazave dhe datat e përcaktuara qartë nga komisionet përkatëse të përcaktuara nga BE. Po ashtu është mbajtur edhe punëtorja për digjitalizimin e transportit të mallrave dhe udhëtarëve me datën 21.05.2025 që korrespondon me veprimet që shtetet duhet të ndërmarrin në avancimin e SIT. Republika e Kosovës ka prezantuar veprimet pozitive të ndodhura me përgatitjen dhe aprovimin e Strategjisë SIT dhe Planit të veprimit për zbatimin e sajë. Në takime kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e MMPHI-së të cilët janë bartës të politikave të SIT dhe pjesë kyçe për digjitalizimin e transportit në përgjithësi, duke e përfshi edhe Ministrin e MMPHI-së. Ministri ka kërkuar mobilizimin e secilit nga entiteti që përfaqësojnë në plotësimin e obligimeve që dalin në këtë fushë, me detyrime konkrete që janë precizuar nga takimet por edhe kërkesat nga DG MOVE për shtetet e Ballkanit Perëndimorë (WB 6). Transporti MultiModal dhe pjesa e politikave tjera shtetërore për TRAINKOS-in janë mundësi për zhvillimin biznesit të TRAINKOS-it për atë edhe pse ekziston.

IX.6 Koordinimi i proceseve me ARH-në, MMPHI-në dhe institucioneve tjera relevante për proceset që ndërlidhen me këto entitete

Vazhdojnë të mbesin angazhimet në plotësimin e obligimeve ligjore në raport me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Sekretariatit për zbatimin e Traktatit për Transport, Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave (ARH), Ministrinë e Ekonomisë (ME), Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA). Ndër aktivitetet më të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë periudhës raportuese vlen të veçohen:

- Mbetet si obligim dhe imperativ procedurat dhe obligimet që Ndërmarrja duhet të i përcjellë për futjen në funksion të pesë vagonëve të udhëtarëve pas finalizimit të procesit riparimi i mesëm. Pasi që të njëjtit aktualisht janë në Han të Elezit, obligim i radhës i TRAINKOS-it është që zyrtarisht të njoftoj ARH-në kohë e futjes në qarkullim. Natyrisht kjo kur të dihet pasi që aktualisht situata e krijuar me mbylljen e Linjës Fushë Kosovë – Hani i Elezit e pamundëson këtë;
- Procesi i inspektimit të mjeteve lëvizëse në posedim të TRAINKOS-it nga ARH është finalizuar dhe përcjellë zyrtarisht tek TRAINKOS-i më 10.01.2025. Raporti prezanton gjendjen reale të të gjitha mjeteve lëvizëse (tërheqëse dhe të tërhequra), njëkohësisht prezanton rekomandimet që TRAINKOS-i duhet të ketë kujdes për të i plotësuar gjatë vitit 2025;
- Me kërkesën e zyrtarëve të ESK-së është filluar me plotësimin e tabelave të Anketës për Statistikat e Investimeve që i përkasin Ndërmarrjes sonë;
- Për nevojat e Ndërmarrjes INFRAKOS sipas kërkesës që rrjedh nga obligimet ligjore është përgatitur, plotësuar dhe dërguar pyetësi për kënaqshmërinë e klientëve. Në këtë rast si klientë për shërbimet si operatorë dhe shfrytëzues i Terminalit;
- Është punuar, kontrolluar dhe dërguar tek ESK formati i plotësuar në tabela që përmbajnë Anketën për Statistikat e Investimeve të ndodhura në vitin 2023;
- Sipas kërkesës dhe nevojës për të i konfirmuar statistikat për transport me hekurudhë që do të përfshihen në të dhënat që dërgohen në EUROSTAT janë punuar, konfirmuar dhe dërguar tek përgjegjësit në ESK;
- Angazhim përmes përfaqësimit dhe konsultave të brendshme për hartimin e Ligjit të Ri për hekurudhat dhe Ligjit për Siguri dhe Ndërveprueshmëri;
- Finalizimi i procedurave nga ana e TRAINKOS-it për transportimin e Lokomotivës Ambasadore në Augsburg;
- Është organizuar dhe realizuar vizita e rregullt vjetore e përgjegjësve të ARH-së për gjendjen dhe kënaqshmërinë e udhëtarëve gjatë udhëtimit me tren;
- Janë përgatitur dhe dorëzuar raportet e rregullta mujore për statistikat e transportit të realizuar nga TRAINKOS-i në ARH;
- Është punuar me ARH-në dhe ka përfunduar procedurat e rregullta në shqyrtimin e kërkesë sonë për Ri licencimin e 6 makinistëve dhe konfirmimin e mos licencimit të makinistëve që nuk llogarisim në vazhdimin e punës si makinist në Ndërmarrje. Kjo në bazë të listës së makinistëve më 19.03.2015 që ju ka skaduar licenca e vlefshme për 10 vjet;
- Për nevojat e raportimeve dhe evidencave nga ARH është kërkuar konfirmimi i transportit të realizuar nga TRAINKOS për vitet 2022, 2023 dhe 2024. Të njëjtat janë analizuar, ri konfirmuar dhe dërguar me kohë sipas kërkesës;
- Janë kompletuar të dhënat (statistikat në baza mujore) sipas kërkesës së ASK dhe obligimeve ligjore për statistika në baza mujore dhe

X.SFIDAT KRYESORE GJATË PERIUdhËS PRILL – QERSHOR 2025 DHE VEPRIMET PËR TË ARDHMEN

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025, HK-Trainkos Sh.A. është përballur me një sërë sfidash që kanë ndikuar drejtpërdrejt në funksionimin dhe performancën operacionale të ndërmarrjes. Sfidat më të theksuara përfshijnë:

1. **Ndërprerjet në qarkullim** në linjën Fushë Kosovë – Hani i Elezit për shkak të vonesave në realizimin e projektit për modernizimin e Linjës së 10-të hekurudhore, që po zgjat më shumë se parashikimet fillestare.
2. **Mungesa e mjeteve lëvizëse** – me një flotë të vjetërsuar të lokomotivave dhe vagonëve, transporti i udhëtarëve vazhdon me trena klasikë në mungesë të trenave motorikë më efikasë dhe më ekonomikë.
3. **Kufizimet buxhetore**, që pengojnë investimet në rinovimin e flotës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për udhëtarët dhe mallrat.
4. **Pengesat ligjore dhe institucionale**, përfshirë mungesën e ligjit për sigurinë në komunikacionin hekurudhor dhe boshllëqet në legjislacionin sekondar në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jolojale;
5. **Trashëgimi e rëndë juridike nga ish-Hekurudhat e Kosovës**, me procese gjyqësore të pazgjithura që pengojnë zhvillimin e qëndrueshëm.
6. **Mosfunksionimi i plotë i rrjetit hekurudhor vendor**, që kufizon zgjerimin e shërbimeve dhe ndikimin ekonomik të hekurudhës.
7. **Mungesë e kuadrit teknik profesional**, përballë një strukture të mbingarkuar me staf administrativ dhe moshë të lartë mesatare të personelit ekzistues.

Vetëm përmes një qasjeje të integruar dhe me mbështetje të qëndrueshme nga institucionet relevante, HK-Trainkos Sh.A. mund të rikthehet në rrugën e zhvillimit dhe të luajë një rol më të rëndësishëm në transportin kombëtar.

Fushë Kosovë,
Korrik 2025

Agron Statovci
Kryeshef Ekzekutiv

Për: 

